



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 24.07.2026

**MBLEDHJA Nr. 34,
Datë 28.07.2026, ora 12:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 28.07.2026, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 34 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A. KESH)” sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “DOMA GROUP” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi shqyrtimin e planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 2023-2027.
5. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HIDROINVEST 1” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjeve 35 kV në transformatorin TR-1 në nënstacionin Prrenjas.
6. Mbi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a.a për vitin 2025.
7. Mbi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit “OST” sh.a., për vitin 2025.
8. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI